

02/08/2019

STATUT

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE "Great Mountain Group" sh.p.k.

KREUI

EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 1

Në Durrës, sot më datën 02/08/2019 ( dymijë e nentembedhjetë) ditë e premte, shtetasi me këte identitet :

- **Eduard Molla** atësia Fadil, i datëlindjes 04/10/1955, shtetas shqiptar, lindur në Koplík, Shqipëri dhe banues në Durrës, identiteti i se ciles verifikohet me kartën e identitetit me nr. letërnjoftimi 033645850

Eshte krijuar Statuti i shoqerise sipas ligjit 9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per:

Shoqërinë tregtare me ortakëri dhe me përgjegjësi të kufizuar "**Great Mountain Group**" sh.p.k.

NENI 2

Selia Qëndrore e shoqërisë është në adresën: DURRES Lagjja nr. 3, Rruga G. Durrsaku, Pallati Fly, Kati i dyte, Zona Kadastrale 8512, Durres.

NENI 3

Shoqëria e shtrin aktivitetin tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të krijohen ose anulohen ( në rast se janë çelur ) Seli, Filiale, Agjensi dhe Përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit.

Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë, si Degë apo Përfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë e tillë e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

02/08/2019

#### NENI 40

Kapitali Themeltar i shoqërisë është në likuiditet në shumën 100.000 (njqindmijë) lekë i ndarë në 1 kuote e formuar dhe nënshkruar nga Ortaku i vetem sipas këtij kontributi:

- 1) Eduard Molla kontribues ne shume 100.000 leke me te drejte 1 kuote (100%)

Ortaku ka pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjetër ( të luajtshme apo të paluajtshme), të fituar në rrugë të ligjshme.

Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Ortakët kanë të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e tyre, përfshirë fondet dhe vlerat e kontributit në natyrë bazuar në të drejtën që u njeh ligji ” Për investimet e Huaja ”

Shoqëria dhe të tretët, respektojnë këto transferime sapo tu bëhen të ditura.

Kapitali fillestar mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve. Kuotat e pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emëruara dhe të pandashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

#### NENI 5

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë.

#### NENI 6

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është PA AFAT, duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendrës kompetente për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

#### NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e kontratës së themelimit dhe këtij statuti të saj.

#### NENI 8

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këto drejtime:

-Menaxhimi I pasurise se paluajtshme

02/08/2019

-Shit Blerje te pasurive te paluajtshme.

Konsulence ne fushen e teknologjise finaciare.

E-komerce.

Menaxhimi elektronik i inventareve.

Sisteme automatike te mbledhjes te te dhenave.

Procesime te transaksioneve online.

Marketing dixhital. Platforma ( blockChain ).

Transferimi elektronik i fondeve. Kriptoaluta.

Menaxhimi i portofolave te investimit online.

Menaxhimi elektronik i inventareve.

Sisteme automatike te mbledhjes te te dhenave.

Procesime te transaksioneve online.

Marketing dixhital. Platforma ( blockChain ).

Transferimi elektronik i fondeve.

Kriptoaluta. Menaxhimi i portofolave te investimit online.

- Veprimtari e agjentit per sherbimin e pagesave per te tretet ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke

- Veprimtari te tjera te natyres finaciare te lejuara nga ligji



## NENI 9

Me qëllim arritjen e objektivit të shoqërisë, ajo ka të drejtë të merret me gjithçka që ka lidhje me objektin e saj, duke përmbushur të gjitha veprimet tregtare, për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, finaciare dhe bankare, edhe me veprime të zbuluara (përjashtuar me mbledhjen e fitimit), duke pranuar pjesëmarrjen në fitim si dhe marrjen pjesë në shoqëri të tjera dhe sipërmarrje me objekt veprimtarie analoge, të ngjashme ose të lidhur me të, qoftë direkt, qoftë indirekt.

NENI 10

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e pajisjes me Çertifikatën e Identifikimit të Personit të Tatueshëm ( NIPT ) nga Qendra Kombëtare e Biznesit.



KREU II

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqëria çel llogari bankare në lekë vendi dhe çdo lloj valute, në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Çdo ortak si dhe administrator i përgjithshëm i caktuar në Aktin e themelimit dhe Statutin e shoqërisë, depoziton specimentin e firmës origjinale në bankat ku është çelur llogaria dhe veprimet bankare kryhen me firmën e tij, për veprimtarinë e zakonshme financiare , kryerjen e pagesave, likuidimeve me furnitorët jashtë e brenda vendit të detyrimeve fiskale shtetërore si tatimore, doganore, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, TVSH.

Ndërsa në raste e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe të jashtëzakonshme, që lidhen me transaksione që kanë të bëjnë me blerje të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi i tyre , zmadhime të kapitalit në likuiditet apo në natyrë, vënie në garanci hipotekore apo bankare, ato për çelje dhe marrje kredie, për marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombëtare, Administratori i përgjithshëm i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

NENI 12

- Administratori i përgjithshëm i shoqërisë, emërohet **Eduard Molla** atësia Fadil, i datëlindjes 04/10/1955, shtetas shqiptar, lindur në Koplik, Shqipëri dhe banues në Durrës, identiteti i se ciles verifikohet me kartën e identitetit me nr. letërnjoftimi 033645850

02/08/2019

Bazuar në NENI 95 të Ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 'Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare', administratori Z.Eduard Molla emërohet për një periudhe kohe 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

#### NENI 13

Pjesët e kapitalit themelor, janë në likuiditet, nominative dhe lirisht të transferueshme në mes të ortakëve dhe rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave ndaj njëri tjetrit.

Ato gëzojnë gjithashtu të drejtën e shitjes apo transferimit të kuotave që zotërojnë, persona të tjerë fizik apo juridik, jashtë ortakërisë, vendas ose të huaj, vetëm atëherë kur asnjëri prej tyre nuk ushtron të drejtën e parablerjes.

Shitja apo tranferimi i kuotave tek Ortakët dhe të tretët bëhet me akt noterial.

#### NENI 14

Për tjetërsimin e kuotave në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar, secili ortak është i detyruar të njoftojë me shkrim shoqërinë, e cila brenda 3 muajve nga dita e njoftimit, duhet të marrë vendim me shkrim për lejimin e transferimit. Ky vendim merret me shumicën e votave Pro, të asamblesë së ortakëve që zotërojnë pjesët e kapitalit themeltar.

Kur asambleja e ortakëve me kalimin e 90 ditëve nuk merr vendimin përkatës për miratimin ose jo të kërkesës së njërit ortak për tjetërsimin e kuotave të tij, kërkesa quhet e pranuar.

Kur në mbledhjen e saj asambleja e ortakëve merr vendim për pranimin e kërkesës nga ortaku që e ka bërë atë, ka të drejtën e shitjes dhe transferimit të kuotave që ai zotëron.

Në rast se asambleja e ortakëve merr vendim për refuzimin e kërkesës për shitjen apo tranferimin e kuotave, çdo ortak brenda 90 ditëve, duhet të ushtrojë të drejtën e parablerjes së kuotave, në të kundërt, me plotësimin e këtij afati ortaku kërkues mund ti shesë apo transferojë kuotat e tij tek të tretët, brenda vendit apo jashtë shtetit.

Kur lind nevoja e vlerësimit të kuotave, Ortakët marrin vendim me shkrim për caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar dhe kur nuk bien dakord për një gjë të tillë, ja kerkojnë caktimin e tij Gjykatës së juridiksionit përkatës, vendimi i të cilës është i detyrueshëm, pasi të ketë marrë formën e prerë.

#### NENI 15

Ortakët , secili prej tyre, ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të RSH pjesërisht apo tërësisht kontributet e tij përfshirë dhe Fondet e Kontributet në Natyrë bazuar në të drejtën që parashikon dhe lejon ligji "Për investimet e Huaja"

02/08/2019

Transferimet e pjesëve të Kapitalit themelor duhet të jenë të vërtetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë Ortakët duhet të marrin paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqëria dhe të tretët, duhet të respektojnë këto transferime sapo të bëhen të ditura.

#### NENI 16

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të marrë unanimisht në mbledhjen e asamblesë së ortakëve, i cili nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bërë dhe shenime në regjistrin përkatës.

Me vendim të asamblesë së ortakëve, në dizpozicion të shoqërisë mund të vihen dhe fonde të tjera financiare duke përfshirë dhe shtesa me anë të Kapitalit në Natyrë.

#### NENI 17

Zmadhimi i kapitalit themeltar, mbi bazën e vendimit me shkrim të asamblesë së ortakëve bëhet kur me parë secili ortak ka deklaruar, nënshkruar dhe derdhur vullnetarisht pjesën e kapitalit që kërkon të zmadhojë, si në formën e kontributit në valutë ose lekë dhe në natyrë.

Nuk konsiderohen zmadhim i kapitalit themeltar kontributet e shërbimeve të secilit ortak.

Pas marrjes së vendimit për zmadhimin e kapitalit themeltar, Ortakët duhet të marrin vendim me shkrim dhe për të pasqyruar një rrethanë të tillë në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë duke pasqyruar qartë kuotat apo kontributin e derdhur nga secili ortak.

#### NENI 18

Ashtu sikurse dhe në rastin e zmadhimit dhe kur bëhet zvogëlimi i kapitalit themeltar, merret me vendim me shkrim nga mbledhja e asamblesë së ortakëve dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar e prek ortakun në atë raport të pjesës së kontributit që ai përfaqëson në krijimin e kapitalit themeltar.

Në rastin kur asambleja e ortakëve vendimin për zvogëlimin të kapitalit themeltar e merr për shkakun se humbjet e shoqërisë arrijnë nën limitin e parashikuar dhe lejuar nga kodi tregtar për shoqëritë me ortakëri me përgjegjësi të kufizuar, krahas vendimit për zvogëlimin e kapitalit themeltar, Ortakët duhet të marrin vendim dhe për të përcaktuar:

1-Nevojën e ndryshimit të formës juridike të shoqërisë duke kaluar në një formë tjetër.

2-Ndryshimin e aktit të themelimit dhe të statutit të saj.

3-Të bëjnë publikimin dhe njoftimin e të tretëve , me të cilët Shoqëria ka marrëdhënie kontraktore si dhe të kreditorëve të saj.

#### NENI 19



02/08/2019

Si në rastin kur Ortakët marrin vendim me shkrim, për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar këto ndryshime duhen pasqyruar dhe në aktin e themelimit dhe në statut dhe pasi të jenë legalizuar për bazueshmërinë ligjore dhe autenticitetin e nënshkrimeve para një noteri, dhe ato i dërgohen menjëherë për depozitim QKB, për të bërë shënimet e nevojshme në Regjistrin tregtar të shoqërive tregtare.



### KREU III

## ORGANET DREJTUES TE SHOQËRISË DHE TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

### NENI 20

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

1.Asambleja e Ortakëve

2.Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

### NENI 21

Mbledhja e asamblesë së ortakëve është organi i vetëm me i lartë drejtues e vendimor i shoqërisë dhe ushtron të gjitha kompetencat që i njeh ligji "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",. Asamblesë së Ortakëve që janë krijuar me Ortakëri.

Ortakët kryejnë drejtimin dhe administrimin e shoqërisë, duke respektuar legjislacionin tregtar në fuqi si dhe të drejtat dhe detyra e përcaktuar në aktin e themelimit dhe këtë statut.

Çdo ortak mund tia delegojë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar me vendim të asamblesë së ortakëve, si dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, shtetas shqiptar ose i huaj mbi bazën e prokurës, të bërë me akt noterial.

### NENI 22

Me vendim të asamblesë së ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptar apo të huaj, ose bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë vendit, të zgjerojë objektin e veprimtarisë së saj etj.

### NENI 23

Ortakët e shoqërisë kanë dhe këto të drejta dhe detyra kryesore:

- Te marrin pjesë në drejtimin dhe administrimin e gjithanshëm të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë dhe të çdo veprimtarie tjetër të saj, kur ajo ushtrohet në përputhje me ligjet, aktin e themelimit dhe statutin e saj.
- Të kërkojnë dhe ti japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarisë së shoqërisë, si dhe i të gjitha dokumentave të përpunuara nga Shoqëria, ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e rezultatit ekonomik të bilancit kontabël apo për çdo llogari të çelur, si dhe të asaj likuiduese sipas kontributit të dhënë prej tij.
- Të kryejnë shërbime për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së rregullt e ligjore të shoqërisë.
- Me vendim të asamblesë, Ortakët emërojnë dhe shkarkojnë në çdo kohë administratorin e shoqërisë, si dhe ekspertin kontabël të autorizuar.
- Secili ortak me anë të administratorit Brenda ortakerise ose të atij të emeruar prej tyre jashtë ortakërise dhe kur ky i fundit është i pajisur me prokurë, ushtrojnë dhe të drejtë.
- Mundësohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen se janë të domdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitim prurës të veprimtarisë tregtare të shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj siç mund të jenë :

1. Të lidhin kontrata të ndryshme që kanë për objekt blerjen, shitjen, këmbimin dhe marrjen me qera të pasurive të ndryshme ( të luajtshme dhe të paluajtshme, atë të servitutit, uzufuktit, enfiteozës, franchising, sipërmarrje ndërtimi etj. si me persona fizikë dhe me persona juridikë vendas apo të huaj, me shtetin dhe në rastin e blerjes së pasurive të paluajtshme apo marrjen e tyre me qera për një kohë mbi 9 vjet, si dhe kontratave të servitutit, uzufuktit, enfiteozës, duhet të bëjnë rregjistrimin në Hipotekat e ZVRPP të rrethit të juridiksionit përkatës si për transkriptimin e pronësisë në favor të shoqërisë apo kalimin e kësaj pasurie në posedim ligjor.

Çdo blerje e pasurive të mësipërme, konsiderohet dhe si shtesë e kapitalit në natyrë.

2. Të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave shtetërore dhe private, bankat e çdo niveli etj. që kanë të bëjnë me garancitë, sipërmarrjet, marrjen e kredive, të siguracioneve dhe risiguracioneve për jetën dhe dëmet, transportit, kryerjen e veprimeve doganore për zhdoganimin e mallrave të importuara, deklarimin e atyre të eksportuar, plotësimit në kohë dhe me rregullsi të dokumentacionit fiskal, tatimor, bankar etj.

Në raste kur veprimet juridike kryhen nga administratori i emëruar nga Ortakët ose personi që përfaqëson njëri nga Ortakët mbi bazën e prokurës, këta janë të detyruar që në përfundim të realizimit të veprimit përkatës të njoftojnë menjëherë dhe ti japin llogari asamblesë së ortakëve.



02/08/2019

Përfaqësimi i shoqërisë, në marrëdhëniet me të tretët si brenda vendit dhe jashtë shtetit si rregull dhe përgjithësisht i përket secilit Ortak.

#### NENI 25

Çdo Ortak dhe Administratori i Shoqërisë, i emëruar prej Ortakëve kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të Shoqërisë, të marrin në punë specialistë dhe shtetas të ndryshëm madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke lidhur Kontratën sipas kriterëve që parashikohen në Kodin e Punës në fuqi, të miratuar me Ligjin Nr.7961 dt 12/07/1995 dhe shtesat e mëpasme plotësuese të tij dhe me Ligjin Nr. 7703 dt 11/05/1993 “Për Sigurimet Shoqërore” si dhe në përputhje me rregullat teknike dhe të disiplinës profesionale të caktuara nga ana e punëdhënësit. Administratori përmban përgjegjësi ligjore penale sipas ligjit 9901 “Per tregtaret dhe shoqëritë tregare”, për çdo mosmarreveshje perndiqet në Gjykatën e Rrethit, Durres

### KREU IV

#### BILANCI, TE ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

#### NENI 26

Veprimet ekonomiko-financiare të Shoqërisë, mbyllen me datën 31 Dhjetor të çdo viti.

Nxjerrja e Bilancit financiar vjetor, bëhet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës, nga data e mbylljes së vitit financiar.

Për nxjerrjen e rezultatit Kontabël të Shoqërisë, mbi bazën e Aktivit dhe Pasivit nga me vendim të Ortakëve caktohet një Ekspert Kontabël i Autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë dhe verifikojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë Ekonomiko Tregtare të Shoqërisë, si atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë mbi bazën e Vendimit të marrë nga Ortakët e Shoqërisë.

Në përfundim të Kontrollit, Eksperti Kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të Bilancit Financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t’ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, i cili është Organi i vetëm për të shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

#### NENI 27

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor, duhet bërë me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi kontabilitetin dhe atyre të sistemit të Tatim Taksave që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtari tregtare.

02/08/2019

Eksperti Kontabël i autorizuar përveç të drejtave, ka edhe këto detyrime:

- 1) Garantoni Asamblesë së Ortakëve se llogaritë vjetore janë të regullta dhe Bilanci është nxjerrë me saktësi dhe konform rregullave të Ligjit "Mbi Kontabilitetin".
- 2) Të pasqyrojë me vërtetësi rezultatet e operacioneve të vitit të kaluar financiar dhe gjëndjen reale financiare të Shoqërisë në mbylljen e vitit financiar të aktivitetit tregtar të saj.
- 3) Të verifikojë përputhjet me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna nga Administratorët e Shoqërisë në Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve, duke përfshirë dhe dokumentat për gjëndjen financiare që ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblesë së Ortakëve.
- 4) T'i bëjë të njohur Ortakëve dhe Administratorit të Shoqërisë: Kontrollat dhe verifikimet që janë bërë prej tij për kontrole periodike ose vjetore, duke vënë në dukje parregullsitë apo pasaktësitë e konstatuara, masat ligjore për rregullimin e tyre, etj.

#### NENI 28

Eksperti Kontabël i autorizuar është përgjegjës ndaj Shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme të shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregtar të Shoqërisë, por nuk është përgjegjës kur këto Dëme shkaktohen pa dijeninë e tij dhe nga veprimet me faj të Administratorit të Shoqërisë.

#### NENI 29

Bilanci Kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të marrë nga Ortakët në mbledhjen e asamblesë së ortakëve, në të cilën jo vetëm që dokumentohet aprovimin e tij por dhe që përcakton dhe në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore, sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të aktivitetit të shoqërisë por dhe për garantimin e veprimitarisë së rregullt të saj, duke patur parasysh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit të veçantë, etj.

#### NENI 30

Për formimin e fondit rezervë, që emërtohet " Rezervë e domosdoshme " Ortakët vendosin që nga fitimi i akumuluar gjatë vitit financiar, pasi zbriten humbjet e vitit të mëparshëm, të lërë të paktën 1/20 e vlerës së Fitimit të realizuar.

#### NENI 31

Të ardhurat neto ( dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi tatimor e fiskal apo likuidimin e pagesave ose ekzekutimin e detyrimeve (debive) ndaj të tretëve, i kalojnë në pronësi, Ortakëve në raport me përqindjen e Kontributit financiar që ata kanë dhënë në krijimin e Kapitalit Themeltar.

#### NENI 32

02/08/2019

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë, mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar Shoqëria siç mund të jenë:

- a) Humbja e Kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga mënyrat e parashikuara nga Ligji “ Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare ”
- c) Me kërkesën e njërit Ortak dhe kur kjo pranohet nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve.

Në këtë rast Ortakët, marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe lëshuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

### NENI 33

Akti i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në aneksin e regjistrit Tregtar.

### NENI 34

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilave Shoqëria është Kreditore dhe për ekzekutimin e plotë të detyrimeve (debive) që Shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë, apo personave fizike ose juridike vendas apo të huaj.

### NENI 35

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht Ortakët duhet ta zgjidhin në mirekuptim në të kundërtën çështjen mund ta bëjnë objekt konflikti gjyqësor.

Te drejtën e ngritjes së Padisë gjyqësore, në rast konflikti civil, çdo Ortak e disponon në mënyrë të pavarur, duke e ngritur atë në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Durrës ose në Gjykatën ndërkombëtare të Parisit.

### NENI 36

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut i referohet udhëzimeve plotësuese e konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të dhëna nga ana e Ortakëve të Shoqërisë si dhe hapësirave juridike lejuese të Legjislacionit në fuqi dhe normave ndërkombëtare.

### NENI 37

Ky statut u redaktua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare **“Great**

02/08/2019

**Mountain Group** “**SHPK**” dhe nënshkruhet prej tyre në të gjitha kopjet duke u venë emri, mbiemri dhe firma origjinale.

ORTAKËT THEMELUES

TE SHOQËRISË TREGTARE ME ORTAKERI “**Great Mountain Group**” SHPK

Miratues të këtij Statuti

2) EDUARD MOLLA

*Eduard Molla*

*[Signature]*